



## KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. \_\_\_\_\_ /2019

Datë: 25.07.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 10 të rendit të ditës: Propozim- Vendim për themelimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale sipas vendimit 01nr.20-37472 i datës 21.07.2016, e miratoi këtë:

### V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së paluajtshme komunale në parcelën kadastrale me nr. 1637/1 Z K Gjakovë Qytet, sipas vendimit paraparak 01nr.20-37472 i datës 21.07.2016, me këtë përbërje :
  1. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
  2. z. Ferdinand Kola, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
  3. z. Muharrem Musa, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
  4. z. Bekim Jupa , përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
  5. z. Idriz Daci përfaqësues i sektorit jo qeveritar .
2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që t'i zhvilloj procedurat e parapara me Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronën sipas vendimit paraparak 01nr.20-37472 i datës 21.07.2016 .
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
  - Anëtareve të Komisioni .
  - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit

